



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije -- Ministry of Education, Science,
Technology and Innovation

Datë: 15-07-2022
Nr. 5-1772

Komisioni për licencimin e BPrAL / kolegjeve private, i Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në mbështetje të dispozitave ligjore nga neni 11 paragrafi 3 dhe 4, dhe neni 14 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës nr. 04/L-037 dhe në bazë të neneve 5, 6, 7, dhe 10 të Udhëzimit administrativ nr. 25/2012 për Licencimin e Bartësve Privat të Arsimit të Lartë, shqyrtoi kërkesën nr. 073 të datës 18.01.2022 të parashtruar nga BPrAL-Kolegji “ IBCM ” dhe mori këtë :

V E N D I M

1. Licencohet Bartësi Privat i Arsimit të Lartë - kolegji “ IBCM ”, me seli në Mitrovicë, për periudhën 01.10.2022 deri më 31 dhjetor 2024.
2. Licenca zgjat për aq kohë sa institucioni në fjalë validohet, akreditimi ndërkombëtar i programeve, sipas vendimeve nr. 1354/19, datë 29.07.2019, nr. 2749/20, datë: 13.11.2020 dhe vendimit nr. 3037/ 21 i datës: 21.08.2021, nga Agjencia e Kosovës për Akreditim.
3. Obligohet BPrAL – kolegji “IBCM” me seli në Mitrovicë që në afatin optimal të dërgoi në Komisionin për Licencim të MASHTI, gjendjen financiare të funksionimit të tij si institucion, në të kundërtën komisioni mund ta tërheq licencën.
4. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Në mbështetje të dispozitave ligjore të cekura më lartë, Komisioni për licencim i BPrAL në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, pas shqyrtimit të kërkesës nr. 037 i datës 18.01.2022 të parashtruar nga Kolegji “IBCM” me seli në Mitrovicë, vlerëson se parashtruesi i kërkesës i plotëson kushtet dhe kriteret ligjore për licencim.

BPrAL-kolegji "IBCM" ka siguruar zotim për mbështetje financiare nga Bashkimi Evropian dhe ka pranuar letër zotimi për gjetjen e zgjidhjes për qëndrueshmëri afatgjate për financim. Zotimi i BE dhe Qeveria e Republikës së Kosovës me nr. 052/2022, të datës: 12.05.2022 dhe të MASHTI nr. 01B/584, të datës: 24.03.2022. Në këtë drejtim, kolegji duhet ta realizoj kërkesën sipas pikës 3 të këtij vendimi, ndryshe rrezikon tërheqjen e licencës nga komisioni për licencim i MASHTI.

Komisioni për licencim i MASHTI duke marrë parasysh faktet e këtij institucioni të paraqitura në dokumentacionin e kompletuar ligjërisht për aplikim, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim, mund të parashtojë ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi te Sekretari i përgjithshëm i MASHTI.

Vendimi u dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës;
2. Komisionit për licencim;
3. Sekretarit të përgjithshëm;
4. DALSHT;
5. Inspektoratit të arsimit;
6. Arkivit.

Kryetar i Komisionit

Burim Gashi

